

VENDIM
Nr.545, datë 3.8.2005

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR, JOPUBLIK,
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË 9-VJEÇARE, CIKËL I LARTË “MEMORIAL
INTERNATIONAL SCHOOL”, QË DO TA ZHVILLOJË MËSIMIN EDHE NË GJUHËN
ANGLEZE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e institucionit arsimor, jopublik, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare, cikël i lartë “Memorial International School”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze, në qytetin e Tiranës.
2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano